



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1567/5 prot

Pukë, më, 20.10.2025

VENDIM
Nr. 40 , datë 17. 10. 2025

“PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TE SIPERFAQES 0.5 HA PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE TË KËRKIM-ZBULIMIT HIDROKARBURE, GJELOGJIKE E MINERARE, UJI, VENDOSJE OBJEKTESH TË NDRYSHME NDIHMËSE NË SIPERFAQJE EKONOMINE PYJORE KRRAB-BUSHAT PARCELA NR.48,49 NE PRONESI TE BASHKISE PUKE SUBJEKTIT “KOLA sh.p.k”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ligj Nr.57/2020 “Per Pyjet ,si dhe Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 “Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike”, Ligjin nr.107/2014 date 31.07.2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 433 date 08.06.2016 “Per transferimin ne pronesi te Bashkive te fondit pyjor e kullosor publik.”, V.K.M-ve nr 888,datë 27.12.2022, “Për rastet e dhenjes ne perdorimi dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit ,procedurat dhe dekontacioni perkates per ndryshimin e siperfaqeve dhe paksimin ne volum nga fondi pyjor kombetar apa zgjerimin e tyre; VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 “Përpërcaktimin e cmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”.Udhezimin e Ministris te Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 “Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenie ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik”,Urdherin e kryetarit te bashkise Nr.274 date 12/09.2025 per hartimin e raportit e vlersimit teknike-ekonomik me propozim te Kryetarit te Bashkise, Keshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2025;

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënjen në përdorimi të siperfaqjes 0.5 ha për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në siperfaqje,me afate 10 (vjecarë) nga Subjekti “Kola”Sh.p.k në ekonominë pyjore Krrab-Bushat parcela nr.48,49 në pronesi të bashkisë Pukë.
2. Vlera vjetore e dhenjes ne perdorim me kontrate qeraje te jete sipas studimit te raportit te vlersimit tekniko-ekonomik te bazuar ne piken 12 shtocen 1 VKM Nr.559 datë 29.07.2022 “Përpërcaktimin e cmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”

3. Autorizohen Drejtoria e Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave te ndjeke procedurat e nevojshme për lidhjen e kontratës në zbatim të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave për zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” , neni 55, pika 6.
6. Vendimi u shpall me datë **20.10. 2025**.

Vota të vlefshme gjithsej 10

Vota pro 9 , vota kunder 0 , vota abstenim 1

SEKRETARI

Hazbi Terbuni



KRYETARI

Gjon **GJOKA**



06.11.25

H. Verhami
A. Doli
per wjesh
Zemir



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 673/1
Prot.

Shkodër, më 30.10.2025

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 40, datë 17.10.2025 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar, neni 25, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, shtojca nr.1, pika 9 e VKM Nr. 559, date 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe prodhime drusore dhe jodrusore pyjore”, pika 22/e e Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, shqyrtoi VKB Pukë Nr. 40, datë 17.10.2025 “Për dhënie në përdorim fondi pyjor publik të sipërfaqes 0.5 ha, me qëllim kryerje operacioneve kërkim zbulim hidrokarbure, gjeologjike, minerare...me afat 10 vjeçar ek.pyjore Krrab-Bushat subjektit Kola shpk”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda ANGONI

